

**VENDIM**  
**Nr. 321, datë 18.5.2022**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 279, DATË 12.5.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË OBJEKTIT SOCIAL-KULTUROR, PALLATI I KULTURËS, BASHKIA SHIJAK, DHE CAKTIMIN E BASHKISË SHIJAK SI NJËSI ZBATUESE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” dhe “iii”, 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe të ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

I. Në vendimin nr. 279, datë 12.5.2021, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 192 687 839 (njëqind e nëntëdhjetë e dy milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e tridhjetë e nëntë) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të objektit social-kulturor, Pallati i Kulturës, Bashkia Shijak.”.

2. Pas pikës 2 shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

“2/1. Bashkisë Shijak, në buxhetin e miratuar për vitin 2022, i transferohet fondi në masën 2 086 701 (dy milionë e tetëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e një) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të objektit social-kulturor, Pallati i Kulturës, Bashkia Shijak, në formën e transfertës së pakushtëzuar.”.

3. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Caktimin e Bashkisë Shijak si njësi zbatuese për rindërtimin, mbikëqyrjen dhe kolaudimin e objektit social-kulturor, Pallati i Kulturës, Bashkia Shijak.”.

II. Ngarkohen Zëvendëskryeministri dhe ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Shijak për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR**  
**Edi Rama**